



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.127/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare (OJQ) “Qendra Rinore Shtime”, paraqitur kundër Vendimin të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2681-2025 nga Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, me të cilin u refuzua kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 10.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** e bazuar ankesa e Organizatës Joqeveritare (OJQ) “Qendra Rinore Shtime”, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2681-2025, i datës 06.10.2025, për shkak të mos akreditimit të vëzhguesve për zgjedhje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

II. **ANULOHET** Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2681-2025, i datës 06.10.2025.

III. **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të akreditoj vëzhguesit për zgjedhje të OJQ-së “Qendra Rinore Shtime”, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 07.10.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga organizata joqeveritare “Qendra Rinore Shtime”, e cila pretendon se me datë 06.10.2025, KQZ ka marrë vendim për refuzimin e akreditimit të 49 vëzhguesve të OJQ “Qendra Rinore Shtime”, me arsyetimin se në statutin e organizatës mungon qëllimi i “monitorimit të procesve zgjedhore nga të rinjtë”. Ky vendim është i pabazuar në fakte dhe në ligj, sepse në statutin e OJQ-së “Qendra Rinore Shtime” (i miratuar më 29.05.2025), neni 9- Qëllimi i Shoqatës përcakton qartë: “...Organizata synon të fuqizojë të rinjtë përmes ngritjes së kapaciteteve të tyre [...] dhe monitorimit të procesve zgjedhore nga të rinjtë.” Pra, qëllimi i organizatës përfshin pikërisht aktivitetin e vëzhgimit të zgjedhjeve, në përputhje me kriteret e nenit 54 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Bazuar në këtë kërkojmë që PZAP të anulojë vendimin e KQZ-së nr. 01/2681-2025, të datës 06.10.2025 dhe të urdhërojë KQZ-në që të akreditojë 49 vëzhguesit e OJQ “Qendra Rinore Shtime” për zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025.

Si dëshmi ka bashkangjitur provat: Kopja e vendimit të KQZ-së, datë 06.10.2025 dhe Statuti i OJQ "Qendra Rinore Shtime", i miratuar më 29.05.2025.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar se është në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, më saktësisht paragrafi 1 i nenit 54 ku theksohet se: "Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren më zgjedhjet dhe mbrojtën e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje. Në kategorinë e organizatave joqeveritare vendore me rastin e aplikimit për akreditim, në përputhje me Regulloren 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, kërkojnë dokumentet si: formularin e aplikimit për akreditim të OJQ të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara; Listën e vëzhguesve të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara; Çertifikatën e regjistrimit të OJQ dhe Statutin e OJQ. Të gjitha këto dokumente verifikohen nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike e cila më pas rekomandon KQZ për ose kundër akreditimit të OJQ që ka aplikuar.

Qendra Rinore Shtime ka aplikuar përmes platformës elektronike për akreditim të dyzet e nëntë (49) vëzhguesve për vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale që do të mbahen me 12 Tetor 2025. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në platformë, kjo organizatë është regjistruar si OJQ me datën 8 tetor 2009. Në Statutin e tyre tek neni 9, në mes tjerash përfshinë edhe monitorimin e proceseve zgjedhore nga të rinjtë. Zyra me qëllim të vërtetimit të plotësimit të kriterëve ligjore nga kjo organizatë për tu akredituar për vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale 2025, ka vërjetur se: Statuti i fundit i ndryshuar i kësaj organizate shënon datën 29.05.2025 dhe me ndryshimet e fundit është futur si qëllim dhe monitorim i procesve zgjedhore, ndërkohë në Statutin me të cilin është regjistruar kjo organizatë nuk figuron monitorimi i procesve zgjedhore si qëllim i organizatës. Kjo organizatë ka për qëllim që ti fuqizoj të rinjtë, ndërsa sipas listës së vëzhguesve, në këtë organizatë, mbi 40% e vëzhguesve i përkasin moshës 26 vjeç deri 57 vjeç. Për të thelluar verifikimin e aplikimit për akreditim të kësaj organizate Zyra është konsultuar më Ligjin Nr.08/L-264 për Rininë dhe Udhëzimin Administrativ (MKRS) Nr.11/2024 për Qendra Rinore. Pas të gjitha verifikimeve të bëra Zyra ka konkluduar që duke u nisur nga fakti se kjo organizatë, ka ndryshuar statutin me datën 29.05.2025, dhe e përfshinë në fushëveprim: monitorimin e proceseve zgjedhore, është e pamjaftueshme që të dëshmohet se organizata nga momenti i ndryshimit statutar, është marrë me monitorimin e zgjedhjeve, siç përcaktohet në par.1 të nenit 54 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Siç u theksua më lartë, nisur nga definimi i Ligjit Nr.08/L-264 për Rininë, moshë e rinisë konsiderohet nga 15 deri në 29 vjeç. Ndërkohë 40% e vëzhguesve i përkasin moshës 26 vjeç deri 57 vjeç dhe mbi 25% e vëzhguesve, i ka mbi moshën 29 vjeç. Pavarësisht që sipas par.1.14 të nenit 1 organizata e të rinjëve definohet si organizatë joqeveritare, jofitimprurese, e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që në fushëveprim dhe statutin e saj ka referencë sektorin e rinisë dhe u shërben të rinjve, kjo organizatë ka zgjeruar qëllimin e saj që nuk përkohet me definimin dhe misionin e organizatave rinore sipas legjislacionit në fuqi. Zyra ka pranuar njoftim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Shtimes se organizatës në fjalë në vitin 2019 i ka skaduar afati i licencës për përdorim të Qendrës Rinore. Nga ky njoftim Zyra ka konkluduar që Qendra Rinore Shtime nuk është funksionale për shkak

të mungesës së licencës si dhe mungesës së financimit, gjë që tregon për mungesën e aktiviteteve në fushën e qëllimit të definuar në Statut. Për këtë Zyra i ka rekomanduar KQZ-së për refuzimin e akreditimit e dyzet e gjashtë (46) vëzhguesve të OJQ Qendra Rinore Shtime. Në takimin e datës 06.10.2025 KQZ ka vendosur sipas rekomandimit të Zyrës.

Si provë në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur: Njoftimin nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Shtimes dhe lista e përfituesve të subvencioneve të Komunës së Shtimes.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Paneli vlerëson se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se OJQ “Qendra Rinore Shtime”, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, ka përfunduar aplikimin për akreditim të vëzhguesve si OJQ në Zyrën për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ. Ndërsa Zyra për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ, me datë 06.10.2025 ka nxjerr rekomandim, përmes të cilit refuzohet aplikimi për akreditim i OJQ-së “Qendra Rinore Shtime”, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.10.2025, duke vendosur sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ e ka miratuar rekomandimin e Zyrës, për mos aprovim për akreditimin e vëzhguesve të OJQ “Qendra Rinore Shtime”. Përkatesisht. KQZ me vendimin e datës 06.10.2025, ka konstatuar se OJQ vendore “Qendra Rinore Shtime” ka aplikuar për akreditim për vëzhgim me një statut i cili është ndryshuar për qëllime të akreditimit për zgjedhje dhe që dallon nga statuti origjinal me të cilin organizata është regjistruar, si rezultat bazuar në nenin 54 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës OJQ “Qendra Rinore Shtime” nuk i ka plotësuar kërkesat ligjore për tu akredituar për vëzhgim të zgjedhjeve.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në vendimin e tij të datës 06.10.2025 me numër protokoll 01/2681-2025, nuk mund të pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore që i referohen vëzhguesit e zgjedhjeve, më konkretisht neneve 54 dhe 55 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.08/2025 Vëzhguesit e Zgjedhjeve të KQZ-së të cilat përcaktojnë dispozitat e përgjithshme dhe kualifikimi i vëzhguesve që marrin pjesë në zgjedhje.

Paneli ka gjetur se në këtë rast KQZ ka konstatuar se OJQ “Qendra Rinore Shtime” nuk akreditohet si vëzhgues mbi arsyetimin se e njëjta ka aplikuar për akreditim për vëzhgim me një statut i cili është ndryshuar për qëllime të akreditimit për zgjedhje dhe që dallon nga Statuti origjinal me të cilin organizata është regjistruar, gjë që sipas vlerësimit të panelit është i pajustifikuar një arsyetim i tillë dhe njëkohësisht është i pabazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit zgjedhor.

Me dispozitën e nenit 54 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, parashihet që: *“Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje.”* Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.08/2025 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, të KQZ-së , përkatësisht në nenin 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 shprehimisht parashihet që: *“1. Subjektet politike të certifikuara, organizatat jo qeveritare (OJQ), organizatat qeveritare e ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të aplikojnë për akreditim të vëzhguesve për zgjedhje. 1.1. OJQ që në fushëveprimin e tyre merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut mund të vëzhgojnë procesin zgjedhor.”.*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se OJQ “Qendra Rinore Shtime” ka aplikuar për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të 12 Tetorit 2025, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore nga neni 54 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe neni 2 i Rregullore Zgjedhore Nr.08/2025 të KQZ-së, ndërsa Zyra për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ ka rekomanduar mos akreditimin për vëzhgues të OJQ-së “Qendra Rinore Shtime”. PZAP konsideron se vlerësimi për mos akreditim të OJQ-së, për shkak se e njëjta ka ndryshuar qëllimin e statutit me datë 29.05.2025, dhe e njëjta ka pasur mungesë të aktivitetit në fushën e qëllimit të definuar në Statut që nga fillimi i themelimit të OJQ-së, është i pabazuar. Pasi, duke u bazuar në kriteret ligjore që janë përcaktuar me nenet 54, 55 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren Rregullore Zgjedhore Nr.08/2025 të KQZ-së, rrjedh se OJQ me ndryshimin e statuti të saj me 29.05.2025 ka plotësuar kushtet ligjore për akreditim të vëzhguesve.

PZAP, mori veprime hetimore konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, në të cilin nen thuhet se *“Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme”*. Andaj, Paneli ndërmori veprime hetimore lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është bazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi i të dhënave në sistemin elektronik të OJQ-ve, ka gjetur se organizata joqeveritare “Qendra Rinore Shtime”, në statutin e tyre kanë të caktuar fushëveprimin e tyre i cili është: *“Qëllimi i organizatës është që të fuqizojë të rinjtë përmes ngritjes së kapaciteteve të tyre, promovimit të kulturës, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe avancimit të barazisë gjinore dhe monitorimit të proceve zgjedhore nga të rinjtë. Organizata synon të nxisë një shoqëri gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të ndërgjegjshme për vlerat e saj kulturore, duke krijuar hapësira për pjesëmarrje aktive, dialog ndëretnik dhe bashkëpunim ndërsektorial”*.

PZAP vlerësoi se vendimi i atakuar nuk përmban arsye të bazuara për refuzim të akreditimit për vëzhgues, në pikëpamje të kushteve ligjore të cilat duhet t'i plotësoj një organizatë joqeveritare vendore, përkatësisht vendimi i apeluar nuk ka arritur të ketë një vlerësim të drejtë në pikëpamje të kushteve dhe kriterëve ligjore që nga mekanizmi i brendshëm i KQZ kur ka vlerësuar se në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet për verifikim të vëzhguesve të OJQ-së “Qendra Rinore Shtime”. Paneli vlerëson se arsyetimi i vendimit të atakuar i referohet kushteve për refuzim të cilat nuk janë kushte ligjore të parapara me LZP apo me rregullas zgjedhore, andaj si i tillë ky

vendim është i pabazuar dhe në kundërshtim me nenin 54 të LZP, pasi që nuk janë marrë në shqyrtim të gjitha çështjet dhe faktet vendimtare që kanë të bëjnë me çështjen mbi akreditim të vëzhguesve, Vendimi i kontestuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore, andaj një vendim i tillë nuk konsiderohet i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marrë me respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullores 08/2024 për vëzhguesit e zgjedhjeve.

Andaj Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi konform neneve: 53 paragrafi 1, 131 paragrafi 4, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. Me nenin 131 par. 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet “Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulohet apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala”.*

Paneli ka vlerësuar edhe përgjigjen në ankesë të KQZ-së të datës 08.10.2025, mirëpo nga e njëjta nuk ishte ofruar ndonjë bazë të artikulueshme për të vendosur ndryshe nga ajo siç është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe urdhëroi KQZ-në, që të zbatojë vendimin e PZAP-it konform dispozitës së nenit 118 par. 5 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në kuptim të nenit 54, 55, 118 paragraf 1 dhe 5, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.127/2025, datë: 10.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.